

Termat e Referencës

*“Shërbimi i Hartimit të Projektit të Zbatimit për Sistemin e Hidranteve Kundër
Zjarrit në Parkun Kombëtar të Butrintit”*



1. Informacion i përgjithshëm

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit është themeluar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë (MTKS) dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim.

FMB vepron në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në mënyrë specifike qëllimi i tij është administrimi indirekt i nëzonalave të trashëgimisë kulturore, të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pronë me vlerë universale, në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 *“Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nëzonalave të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”*.

2. Objekti i Procedurës

Objekti i kësaj procedure është ofrimi i shërbimit të studimit, analizës dhe hartimit të projektit të zbatimit për sistemin e hidranteve kundër zjarrit (MNZSH) në Parkun Kombëtar të Butrintit.

Kjo procedurë nuk përfshin zbatimin fizik të punimeve, por vetëm shërbimin e projektimit dhe dokumentacionin teknik përkatës.

3. Kuadri Ligjor dhe Standardet Teknike

3.1. Kuadri Ligjor

Projektimi do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare të mëposhtme (por pa u kufizuar në to):

- Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”;
- VKM nr. 162, datë 19.04.1965 “Mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji”, e ripunuar;
- Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 425, datë 24.07.2015;
- Urdhër nr. 45, datë 09.04.2004 “Mbi ruajtjen e vlerave materiale nga zjarri në depo dhe magazina”;
- Ligji Nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.1099, datë 24.12.2020, “Për Miratimin e Mënyrave të Trajtimit, Normave Teknike, Kriterëve dhe Modeleve të Ndërhyrjeve në Fushën e Ruajtjes së Pasurive Kulturore.

3.2. Standartet Teknike

- EN 13501 – Klasifikimi i rezistencës ndaj zjarrit;
- EN 2 – Klasifikimi i zjarreve;
- EN 14384 / EN 14339 – Hidrante mbi dhe nën tokë;
- EN 12845 (si referencë teknike orientuese);

- EN 1838 – Ndriçimi emergjent;
- EN 1366 – Teste rezistence ndaj zjarrit;
- IEC 79-10 – Klasifikimi i zonave;
- NFPA 10 dhe NFPA 24 (si referencë teknike);
- BS EN B2 – Fire Safety.

4. Konteksti dhe Qëllimi i Projektit

Parku Kombëtar i Butrintit karakterizohet nga prania e vlerave të veçanta natyrore, ekosisteme të mbrojtura dhe monumente të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike.

Rreziku nga zjarret, veçanërisht gjatë sezonit të thatë, përbën një kërcënim serioz për këto vlera.

Qëllimi i këtij projekti është përzgjedhja e një subjekti të kualifikuar që do të ofrojë një zgjidhje teknike, funksionale dhe të qëndrueshme, në përputhje me kërkesat ligjore, teknike dhe specifikat e zonave të mbrojtura.

5. Përshkrimi i Shërbimit dhe Fusha e Projektimit

Subjekti kontraktor do të kryejë, por pa u kufizuar në, aktivitetet e mëposhtme:

5.1 Analiza e Gjendjes Ekzistuese

- Vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen nga zjarri;
- Inventarizimi i burimeve aktuale të ujit;
- Analiza e aksesit për mjetet zjarrfikëse;
- Studimi i zonës me risk zjarri;
- Raport i vlerësimit të ndikimit arkeologjik;
- Skema e furnizimit me energji elektrike.
- Teknika efikase e ndërhyrjes për MNZ në kushtet ekzistuese

5.2 Shqyrtimi i Furnizimit me Ujë nga Liqeni i Butrintit

- Analizë hidrologjike dhe hidraulike e liqenit;
- Vlerësim i kapacitetit të përdorshëm për raste emergjente;
- Analizë e sistemeve të ngritjes, pompimit dhe shpërndarjes;
- Vlerësim i ndikimit mjedisor dhe përputhshmërisë ligjore;
- Identifikim i alternativave të tjera të furnizimit me ujë.

5.3 Projektimi i Sistemit të Hidranteve

- Hartimi i skemës së përgjithshme të sistemit;
- Dimensionimi hidraulik i rrjetit;
- Përcaktimi i vendndodhjes së hidranteve;
- Zgjedhja e materialeve dhe pajisjeve;
- Integrimi me infrastrukturën ekzistuese;
- Projektimi i grupit të pompimit dhe burimeve rezervë;
- Projektimi i furnizimit elektrik dhe ndriçimit emergjent i sistemit të pompimit.
- Përcaktimi në projekt i provës hidraulike të funksionimit pas përfundimit të zbatimit dhe marrjes në dorëzim të rrjetit të MNZ.

- Përcaktimi i zonave që mbulon secili hidrant i parashikuar në projekt.
- Parashikimi i ndërtimit të dhomave për pompat (konsultim gjatë projektimit me konsulentin dhe FMB mbi teknikën dhe metodologjinë)

6. Materialet e Dorëzueshme

Subjekti i përzgjedhur do të dorëzojë:

- Studim fizibiliteti për furnizimin me ujë;
- Projekt zbatimi të sistemit të hidranteve;
- Relacion Teknik;
- Specifikime Teknike;
- Vizatime teknike (DWG) dhe skema hidraulike;
- Llogaritje teknike përkatëse;
- Preventiv të detajuar të punimeve;
- Relacion mbi testimin, kolaudimin dhe vënien në punë të sistemit;
- Plan Operimi dhe Mirëmbajtjeje (O&M);
- Dokumentacion të ndikimit mjedisor dhe në trashëgiminë kulturore.
- Plan vendosje e hidranteve dhe zonat që mbulon secili hidrant.

Dorëzimi do të bëhet në format elektronik (PDF & DWG&PP) dhe në 2 kopje fizike, në gjuhën shqipe.

7. Afati i Realizimit

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë **60 ditë kalendarike** nga data e lidhjes së kontratës dhe deri në miratimin e projektit nga KKTKM.

8. Kriteret e Kualifikimit

Operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Përvojë e dokumentuar në projekte të ngjashme;
- Disponim i stafit të licensuar: inxhinier hidroteknik, ekspert MNZSH, inxhinier elektrik, ekspert mjedisi, arkeolog;
- Aftësi teknike dhe profesionale të ngjashme;
- Përmbushje e kërkesave ligjore për ushtrimin e aktivitetit në fushën e projektimit.

9. Licencat e Projektuesit/Grupit të Projektimit

Subjekti duhet të jetë i licensuar/certifikuar për;

a- Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale në fushën e mbrojtjes civile dhe mbrojtjes nga zjarri, sipas legjislacionit në fuqi.

b-Çertifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi, sipas legjislacionit në fuqi.

c-Licencë profesionale në fushën e "Projektues Instalator" në Kategorinë 4-f "Projektim të sistemeve kundra zjarrit", sipas legjislacionit në fuqi.

ç-Licencë profesionale në fushën e "Projektues Instalator" në Kategorinë 4-c "Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale", sipas legjislacionit në fuqi.

d-Licencë profesionale në fushën "Veprimtari Arkeologjike" në Kategorinë A-1 "Vëzhgim Arkeologjik", sipas legjislacionit në fuqi.

ZONA QË KËRKOHET TË MBULOHET ME RRJETIN HIDRIK TË MNZ

